

# NDJEKJA PENALE E ORGANIZIMIT TË LUFTËRAVE MES QENVE



## **Sipas Nenit 346, paragrafi 3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës,**

kushdo që organizon, financon ose është nikoqir i luftës ndërmjet kafshëve të llojeve të njëjta apo të ndryshme ose organizon apo merr pjesë në bast në këto luftëra, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

Luftërat mes qenve janë një nga format më këqija të mizorisë së kafshëve. Qentë e përdorur për përleshje zakonisht rriten të izoluar, duke kaluar pjesën më të madhe të jetës së tyre në zinxhirë të shkurtër dhe të rëndë. Ata kushtëzohen rregullisht për të luftuar përmes përdorimit të ilaçeve, duke përfshirë steroide për të rritur masën muskulore dhe për të inkurajuar agresivitetin. **Po ashtu, edhe qentë endacak mund të jenë viktimë të "trajtimeve" për qentë e përdorur në luftëra, pasi që përdoren si kafshë në të cilat mund të testohet agresiviteti dhe fuqia e qenve të rritur për përleshje.**

**ABUZIMI NDAJ KAFSHËVE DHE BIXHOZI ILEGAL JANË NË THELB TË VEPRIMTARISË ILEGALE TË LUFTËRAVE ME QEN.**

## **Y LUFTËRAT MES QENVE MUND TË JENË NJË KRIM FILLESTAR QË QON NË VEPRAT TË TJERA KRIMINALE**

**Nga shumë foto dhe video materiale të postuara në rrjetet sociale, vërehet një përfshirje e madhe e të miturve në luftërat e organizuara mes qenve.** Ndjenja e fuqisë dhe kontrollit të fituar nga të pasurit një qen agresiv, si dhe përfitimi i mundshëm financiar, mund t'i joshë të miturit në një skenë nëntokësore që shpesh përfshin aktivitete të tjera kriminale.

## **Y LUFTËRAT MES QENVE MUND TË NDODHIN NË NJË SËRË LOKACIONESH**

**Luftimet mes qenve zakonisht organizohen në orët e hershme të mëngjesit,** dhe në **fshatra** zakonisht zhvillohen në **lokacione të largëta** me pak ose fare frekuentim (përveç pjesëmarrësve), ndërsa në **qytet,** këto luftime mund të zhvillohen në **bodrume apo garazhe,** me një strukturë të mirë-organizuar të dedikuar për t'i izoluar kafshët që të mos mund të ikin.

**Luftimet mund të zgjasin vetëm disa minuta ose disa orë,** dhe të dyja kafshët mund të pësojnë lëndime, duke përfshirë plagë shpuese, çarje, humbje gjaku, lëndime dërrmuese dhe eshtra të thyera. Megjithatë luftimet zakonisht nuk zgjasin deri në vdekje, shumë qen u dorëzohen lëndimeve të tyre më vonë dhe qentë që kanë humbur luftën shpesh braktisen, vriten ose ekzekutohen brutalisht si pjesë e "sportit".



## SFIDAT E NDJEKJES PENALE TË AKTIVITETEVE TË LIDHURA ME LUFTËRAT MES QENVE

- Informimi i mangët i shoqërisë apo institucioneve përgjegjëse për fenomenin kriminal të organizimit të luftërave mes qenve
- Mosraportimi i këtyre veprave nga qytetarët që kanë njohuri dhe prova
- Rastet e luftimeve me qen shpesh përfshijnë numër të madh të të pandehurve (përfshirë të miturit)
- Përndjekja e këtyre veprave kërkon bashkëpunim të disa institucioneve të ndryshme
- Veprat ilegale të organizimit të luftërave mes qenve përfshijnë prova të gjalla të cilat lehtësisht mund të fshihen nga të pandehurit
- Pamundësia e konfiskimit të qenve të përdorur për lufta për shkak të mungesës së mekanizmave adekuatë (infrastruktura e strehimit, kujdesi veterinar, përmirësimet e sjelljes etj.)
- Legjislacioni i mangët

Qentë e përfshirë në aktivitetet e përleshjeve janë viktima dhe prova të krimit dhe shpesh kanë nevojë të veçanta mjekësore që duhen plotësuar dhe probleme me sjellje që duhet të adresohen.

Në Kosovë, **konfiskimi i qenve të përdorur për luftëra nuk bëhet në asnjë rast nga pamundësia e strehimit të përkohshëm shtetëror**. Strehimi i qenve që janë viktima të luftërave mund të jetë i ndërlikuar dhe i shtrenjtë. Mbajtja e kafshëve të konfiskuara në strehimore për një kohë të gjatë, përveç koston së madhe, ka pasoja edhe për vet mirëqenien e kafshëve.

Para çdo operacioni të ndjekjes penale të luftërave me qen, duhet të sigurohet strehimi dhe kujdesi i çdo kafshe që do të konfiskohet.





# SI TË DALLOHEN SHENJAT E QENVE TË PËRDORUR PËR LUFTËRA

Është e rëndësishme të identifikohen shenjat tek qentë që përdoren për luftëra me qen të tjerë.

Nëse jeni dëshmitar i shenjave të mëposhtme, atëherë gjasat janë shumë të mëdha që qentë përdoren për përleshje me qen të tjerë:

- Qen me plagë të shumta, ndoshta me buzë ose veshë të këputur
- Qen të tipit Pitbull, Qen i Sharrit, Kangal, Terrier etj.
- Qen me zinxhir të rëndë, të lidhur në një pemë ose shtëpinë/koliben e qenit ose edhe gjatë shëtitjes
- Shenja të papastërtisë në trupin e qenit
- Ambient shumë i papastër ku qëndron qeni
- Shumë qen të lidhur me zinxhir pak centimetra larg njëri-tjetrit
- Qen të lidhur me zinxhir ose të mbyllur në një hapësirë të izoluar apo të pabanueshme për t'i mbajtur qëllimisht jashtë syrit të njerëzve tjerë



Bashkëpunimi ndër-institucional si dhe bashkëpunimi i komunitetit me institucionet ligjzbatuese është themelor për ndjekje të suksesshme penale të krimit të luftërave me qen!



Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve  
Animal Rights Foundation  
Fondacija za prava životinja